



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

**Njoftim paraprak përqëndrimi
(Rasti TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH)—SIGMA sha)**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur kërkesa e **shoqërisë TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH) me seli në Vjenë, Austri, për të blerë paketën kontrolluese (75 % të aksioneve + 1 aksion) të shoqërisë SIGMA sh.a.** Në bazë të nenit 10, pika b dhe nenit 12, pika 1/a, b të ligjit 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” vlerësohet se kemi një përqëndrim, me anë të të cilit TBIH fiton të drejtën e kontrollit ekskluziv të shoqërisë SIGMA sha dhe si i tillë duhet t’i nënshtrohet procedurës së kontrollit të përqëndrimeve të përcaktuar në ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

2. Aktiviteti i biznesit të shoqërive është si vijon:

- A. TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH), është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hollandez, me adresë : Prins Hendriklaan 52, 1075 BE, Amsterdam, Hollandë. Veprimtaritë kryesore janë shërbimet në fushën e sigurimeve dhe të pensioneve. TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH)“ ka shtrirje në Hollandë dhe Austri. Ajo ka blerë shoqëri sigurimesh në Gjeorgji, Rusi dhe Ukrainë. Aksionerët kryesorë të TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH) janë Vienna Insurance Group që zotëron 60 % të aksioneve dhe Kardan Financial Services B.V me 40 për qind të aksioneve.
- B. Sigma Sh.A., është shoqëri anonime e themeluar sipas ligjeve shqiptare me adresë “Rruga Komuna e Parisit”, Pallatet Lura, kati II, Tiranë, regjistruar në Regjistrin Tregtar me nr. 20 487. Sigma ushtron veprimtarinë e saj në fushën e sigurimit të dëmeve dhe lëshimin e policave të sigurimit. Sigma sh.a zotëron gjithashtu edhe 25 për qind të aksioneve të Garantsig, një shoqëri administruese e fondeve të pensioneve private vullnetare. Objekti i aktivitetit të Garantsig është mbledhja e kontributeve dhe shpërndarja e përfitimeve midis personave që marrin pjesë në Fondin privat të Pensioneve në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

3. Komisioni i Konkurrencës fton palët e interesuara të paraqesin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre për këtë përqëndrim të propozuar.

4. Vërejtjet dhe sugjerimet duhen paraqitur jo më vonë se 10 ditë nga data e këtij njoftimi me faks në numrin 04 234 497, në formë elektronike në adresën competition@caa.gov.al ose në adresën: Autoriteti i Konkurrencës(Sektori i Përqëndrimeve), Rr.Sami Frashëri, Nr.4, Kati IV, Tiranë.